



TERMAT E REFERENCËS

Emri i Projektit	Trajnim - Qasja e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit
Lloji i shërbimit	Organizimi e trajnimeve mbi temën "Qasja e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit" për stafin e menaxherial dhe profesional.
Vendndodhja	Prishtinë
Lloji i konsulencës	Trajner profesionist
Kohëzgjatja	3 ditë
Data e pritshme e fillimit	Dhjetor, 2024
I raportohet	SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë



1. Hyrje

Këto Terma të Referencës (TOR) janë përgatitur për të shërbyer si udhëzues dhe bazë për kërkesën e propozimeve nga individë, ekspertë, ose kompani të specializuara në organizimin dhe ofrimin e trajnimeve. Ky trajnim ka për qëllim fuqizimin e stafit të organizatës përmes trajnimit me temën “Qasja e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit”. Trajnimi synon të zhvillojë kapacitetet profesionale të stafit për të kuptuar dhe adresuar ndikimin e traumës te fëmijët dhe të rinjtë, duke ofruar praktika të sigurta, mbështetëse dhe efektive në punën e tyre të përditshme.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve International është organizata ombrellë për federatën globale të 118 shoqatave kombëtare SOS Fshatrat e Fëmijëve, duke punuar në më shumë se 2500 vende programesh në të gjithë botën. Ne punojmë së bashku me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri. Në mënyrë unike, ne ofrojmë kujdes afatgjatë familjar për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror (shërbimi i kujdesit alternativ), dhe ne punojmë me familje dhe komunitete në nevojë për t'i ndihmuar në forcimin e tyre dhe parandalimin e braktisjes së fëmijëve (shërbimi i forcimit të familjes, FF). Kujdesi alternativ i SOS zakonisht organizohet në formën e një grupi familjesh të SOS, ku secili prind SOS kujdeset për një grup të vogël fëmijësh.

Që nga viti 2001, SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë ka qenë aktiv në fushën e mbrojtjes sociale përmes sigurimit të shërbimeve të kujdesit të drejtpërdrejtë me cilësi të lartë për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror përmes zhvillimit të mjediseve alternative të kujdesit familjar dhe shërbimeve me bazë në komunitet për familjet në rrezik. Brenda SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe programeve të forcimit të familjes, ne punojmë së bashku drejt vizionit tonë për një botë ku "çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri. SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë punojnë në partneritet me bartësit e detyrës, organet shtetërore, palët kryesore të interesit, organizatat kryesore dhe ofruesit e shërbimeve në fushën e mbrojtjes sociale dhe fëmijët në nevojë dhe krijojnë mundësi që të rinjtë të përfshihen në ndikimin, formësimin, modelimin dhe kontributin në politikat dhe zhvillimin e shërbimeve dhe programeve.

1.1 Konteksti i programit

SOS Fshatrat e Fëmijëve synon të forcojë kapacitetet profesionale të stafit të saj për të ofruar shërbime të cilësisë së lartë dhe për të përmbushur nevojat e fëmijëve dhe të rinjve, veçanërisht atyre që mund të kenë përjetuar trauma. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që stafi të ketë njohuri dhe aftësi mbi qasjen e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit, e cila thekson kuptimin e ndikimit të traumës dhe ofrimin e mbështetjes së ndjeshme ndaj kësaj gjendjeje.

Puna me fëmijët dhe të rinjtë kërkon qasje profesionale që fokusohet te ndërtimi i marrëdhënieve të sigurta, krijimi i mjediseve mbështetëse dhe zhvillimi i mekanizmave efektivë për të adresuar nevojat emocionale dhe psikologjike të tyre.

Përmes këtij programi, synohet të ngriten kapacitetet e shërbimeve për fëmijët, të rinjtë dhe prindërit/ kujdestarët duke kontribuar në zhvillimin e tyre të shëndetshëm dhe mirëqenien e përgjithshme.

1.2 Përmbledhje e programit

Fondacioni ofron shërbime për rreth 600 fëmijë dhe të rinj përmes këtyre tre programeve kryesore:

- 1. Kujdesi Alternativ për Fëmijë pa Kujdes Prindëror**
Ky program ofron përkujdesje familjare përmes 6 SOS Familjeve, duke mbështetur 30 fëmijë të moshës 0-18 vjeç pa përkujdesje prindërore.
- 2. Programi i Gjysëpavarësisë**
Ky program mbështet 11 të rinj të moshës mbi 19 vjeç, të cilët janë pa përkujdesje prindërore, për të siguruar një tranzicion të qëndrueshëm drejt pavarësisë.
- 3. Programi i Fuqizimit të Familjes**
Me prani në tre lokacione në Kosovë, ky program ofron shërbime të integruara psikologjike dhe sociale për mbi 600 fëmijë dhe të rinj që janë në rrezik braktisjeje, si dhe për familjet e tyre.

Qëllimi i angazhimit

Fondacioni kërkon të përmirësojë më tej kapacitetet e stafit të tij përmes organizimit të punëtorive që fokusohen në qasjen e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit. Ky trajnim synon të fuqizojë ekipet për të adresuar më mirë nevojat emocionale, psikologjike dhe sociale të përfituesve të programeve, duke rritur cilësinë e shërbimeve që ofrohen.

1.3 Koha e angazhimit

Koha që synohet të fillohet puna për ofrimin e trajnimit është dhjetor i vitit 2024 dhe angazhimi në kuadër të këtij angazhimi do të përfundojë në dhjetor 2024.

Trajnime për “qasjen e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit ” **është paraparë të jetë një ditorë dhe do të organizohet për 3 grupe profesionistësh e që gjithsej angazhimi do të zgjasë 3 ditë** (duke përfshirë raportin përfundimtar).

2. Objektivat dhe fushëveprimi

Ngritjen e kapaciteteve të stafit për të ofruar shërbime të specializuara në fushën e punës me fëmijë, të rinjë që kanë përjetuar trauma, duke përdorur një qasje të informuar për trauma dhe metoda të përshtatshme për punën me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit



Trajnimi do të përqendrohet në qasjen e informuar për traumën dhe në metodat e punës me fëmijët, të rinjtë, dhe prindërit, duke synuar zhvillimin e aftësive të stafit për të adresuar nevojat e kësaj grupmoshe në mënyrë efektive dhe të ndjeshme ndaj traumës.

Objektivat:

1. Të ofrohet një kuptim i thelluar i konceptit të qasjes së informuar për traumën dhe ndikimit të saj në zhvillimin e fëmijëve dhe të rinjve.
2. Të prezantohen strategji praktike dhe teknika për mbështetjen e fëmijëve dhe të rinjve që kanë përjetuar trauma.
3. Të fuqizohen prindërit dhe kujdestarët për të krijuar një mjedis të sigurt dhe mbështetës për fëmijët.

Fushëveprimi:

- Trajnimi do të përfshijë qasje teorike dhe praktike, duke përdorur studime rasti dhe metoda interaktive për të lehtësuar procesin e të mësuarit.
- Hartimi dhe dorëzimi i një raporti përfundimtar, i cili përmbledh progresin dhe rekomandimet për vijueshmërinë e qasjes së informuar për traumën në punën me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit.

Rezultatet e Dëshiruara:

1. Pjesëmarrësit të fitojnë njohuri të avancuara mbi traumat dhe ndikimin e tyre në zhvillimin emocional, social dhe psikologjik të fëmijëve dhe të rinjve.
2. Të zhvillohen aftësi praktike për të zbatuar qasjen e informuar për traumën në punën e përditshme me fëmijët dhe familjet.
3. Përgatitja e stafit për të implementuar qasjen e informuar për traumën si pjesë e shërbimeve të organizatës.

3. Plani i punës dhe rezultatet e pritshme

Metodologjia e trajnimit duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe të respektojë normat dhe parimet e shoqërisë, si dhe etikën profesionale. Plani i punës për trajnimin që ofron trajneri duhet të përfshijë në detaje metodologjinë, hapat dhe procedurat e ndjekura për realizimin e trajnimit, duke përfshirë dhe mënyrën e vlerësimit të përfitimeve dhe rezultateve të trajnimit.

Metodologjia duhet të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në, informacionet e mëposhtme:

- Përshkrimi i të gjitha veprimeve që lidhen me definimin dhe zhvillimin e metodologjisë së trajnimit.

Kjo metodologji duhet të jetë fleksibël, praktike dhe e përshtatshme për stafin e organizatës, duke krijuar një mjedis që promovon mësimin e integruar dhe të qëndrueshëm për të punuar me individë që kanë përjetuar trauma, veçanërisht fëmijë dhe të rinj.

Së fundi, duhet të përgatitet dhe dorëzohet raporti përfundimtar.

Produktet:

1. Drafti përfundimtar i modulit trajnues (përfshirë materialet e trajnimit, slidet prezantuese, shembuj praktikë, energjikët, diskutimet ndërvepruese, testet para dhe pas trajnimit dhe agjendën).
2. Organizimi punëtorisë/trajnimit me profesionistë të SOS Fshatit të Fëmijëve
3. Raporti përfundimtar, raporti i vlerësimit pas trajnimit, një përqindje e përgjithshme e pikëve të testimit të profesionistëve të trajnuar për mbrojtjen e fëmijëve dhe rekomandime për veprime të mëtejshme.

4. Shkathësitë e kërkuara (Përvoja dhe Kualifikimet)

- Trajneri duhet të kenë diplomë universitare ose përvojë ekuivalente profesionale;
- Trajneri duhet të ketë përvojë dhe kompetencë ofrimin e trajnimit në vlerësim në fushën traumës
- Trajneri duhet të kenë aftësi të forta analitike dhe konceptuale;
- Trajneri duhet të ketë përvojë e mëparshme në rolin e ngritjes së kapaciteteve;
- Të kenë aftësi të shkëlqyera të shkruarit dhe komunikimit;
- Dtrajneri duhet të ketë aftësi të mira personale dhe ndërpersonale të punës në ekip.
- Trajneri duhet të jetë i njohur me standardet etike për çështje që lidhen me fëmijët dhe kërkohet që të nënshkruajnë dhe t'i përmbahen Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve;
- Autori nuk duhet të përdorë materiale të mbrojtura nga e drejta e autorit.

5. Kriteret për përzgjedhje

Kriteret	Pikët maksimale
<ul style="list-style-type: none">• Përvoja e ekspertëve në angazhime të tilla. Vlerësimi bëhet në bazë të kualifikimeve dhe përvojës në ofrimin e trajnimeve në fushën e kërkuar.	30
<ul style="list-style-type: none">• Propozimi i konceptit të metodologjisë së trajnimit duke përfshirë referencat për materialet dhe agjendën e trajnimit.	40
<ul style="list-style-type: none">• Çmimi i propozimit financiar.	30
Totali	100

6. Kohëzgjatja dhe organizimi

Punëtoritë do të organizohen në muajin Dhjetor 2024 me gjithsej 3 ditë angazhim. Punëtoritë do të mbahen në Prishtinë, në ambientet e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë.

7. Kushtet e pagesës

Pagesa do të bëhet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë, si pagesë bruto pas shërbimit të dhënë ndërsa ndalesa për tatim në të ardhurat personale dhe kontributi pensional do të bëhet



sipas ligjit në fuqi. Realizimi i pagesës do të bëhet me transfer bankar, jo më vonë se 7 ditë nga pranimi i raportit dhe evidencës së angazhimit.

8. Shtojca - Politika e mbrojtjes së fëmijëve dhe kodi i mirësjelljes së SOS Fshatrave të Fëmijëve

SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë kanë një politikë dhe kod të mirësjelljes për mbrojtjen e fëmijëve, nga konsulentët e ndërmarrjeve pritet të respektojnë dhe do të kërkohet të nënshkruajnë një deklaratë përkushtimi ndaj politikës. Kjo do të ndodhë me nënshkrimin e kontratës, së bashku me një orientim të kompanisë në proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve dhe rregulloret e mbrojtjes së të dhënave.

Para fillimit aktual të mbledhjes së të dhënave, duhet të sigurohet një verifikim policor, në rast se planifikohen të dhëna të ndjeshme.

Përveç sa u tha më sipër, fushat e mëposhtme kryesore për shqyrtim etik duhet të merren parasysh: <http://childethics.com/ethical%20guidance/>

Graham, A., Powell, M., Taylor, N., Anderson, D. & Fitzgerald, R. (2013). Kërkime etike që përfshijnë fëmijët. Firencë: UNICEF Zyra e Kërkimit - Innocenti.

9. Udhëzim për kandidatët (Procesi i dorëzimit të Ofertave)

Kandidatët janë të mirëpritur të paraqesin propozimin e tyre për mbajtjen e trajnimit “ Qasja e informuar për traumën dhe metodat e punës me fëmijët, të rinjtë dhe prindërit ” – në mënyrë elektronike në formatin PDF në procurement1@soskosova.org
Propozimi dhe të gjitha dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen në gjuhën shqipe.

10. Dokumentet për tu dorëzuar:

- Kopja e letërnjoftimit

- Koncept propozimi për metodologjinë e trajnimit duke përfshirë referencat për modulet/ materialet dhe agjendën e trajnimit,
- Oferta duhet të jetë e nënshkruar,
- Propozimi Financiar duhet të paraqitet në EURO bruto
- Emri dhe detajet e kontaktit të ekspertëve si dhe përshkrimi i përvojave përkatëse të së kaluarës në vlerësime të ngjashme (CV dhe lista e trajnimeve të mëparshme të ofruara),
- Tre referenca me shkrim të punës së mëparshme të ngjashme.

Vërtetimi të cilin nuk jeni nën hetime (dorëzohet para nënshkrimit të kontratës)
Oferta financiare duhet të jetë e vlefshme për 30 ditë pas nënshkrimit të kontratës

Afati i fundit për dorëzim:

Afati i fundit për aplikim është data **06.12.2024**